Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORT I AUDITIMIT PËR SHËRBIMIN SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR TË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Fejzullah Fejza (udhëheqës i ekipit), Neslihane Mati dhe Krenare Pirana (anëtare të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....6

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm....7

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....11

4 Qeverisja e mirë....22

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....25

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA....31

Shtojca II: Letër konfirmimi....34

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 30.10.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe servisimit të pajisjeve mjekësore në vlerë 416,594€, gabimisht ishin planifikuar dhe realizuar nga kategoria investime kapitale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Theksimi i Çështjes ndërlidhet me buxhetimin dhe realizimin jo të duhur të shpenzimeve për kategorinë e investimeve kapitale.	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të PFV(shih nënkapitulli 2.1).
Kontrollet kyçe të brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në shumë fusha, ndërsa dobësitë në veçanti janë vërejtur në kategorinë paga dhe meditje, mallra dhe shërbime dhe investime kapitale.	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të kryej një rishikim të procesit në këto kategori dhe të forcoj kontrollet ku janë identifikuar dobësitë (shih çështjet A2, A3, A4, A5, A6, A7, B1 dhe B2).
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë duke u konsoliduar dhe forcuar. Aktiviteti i auditimit të brendshëm është duke mbështetë zhvillimet në këtë fushë.	Bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj edhe më tutje se aranzhimet e Qeverisjes janë duke u forcuar për ta ngritur edhe më tutje efektivitetin operativ (kapitulli 4).

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

ShSKUK është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të ShSKUK-së gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

- Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe servisimit të pajisjeve mjekësore në vlerë 416,594€, gabimisht ishin planifikuar dhe realizuar nga kategoria investime kapitale.

Keqklasifikimi i këtyre shpenzimeve kishte ndodhur për arsye se ato ishin planifikuar të shpenzoheshin në mënyrë jo adekuate në kategorinë e investimeve kapitale, ndërsa nuk i plotësojnë kushtet për të qenë investime kapitale. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ShSKUK-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013/MF-shpenzimi i parave publike, si dhe Rregulloren MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Përveç gabimeve të cilat kanë ndikuar në theksim të çështjes, PFV përmbajnë edhe gabimin si:

- Neni 19.3.1- Pasuria jo financiare kapitale në PFV me vlerë mbi 1,000€, nuk prezanton vlerën e saktë të pasurive, për faktin se pasuritë me vlerën 57,683€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë, dhe rrjedhimisht edhe PFV-të ishin nën deklaruar për të njëjtën vlerë. Kjo kishte ndodhur për shkak se pagesat për këto pasuri ishin bërë në fund të vitit 2018 me ç'rast zyrtari i pasurisë nuk kishte arritur t'i regjistroj brenda periudhës raportuese;
- Te neni 16 - Raporti i të arkëtueshmëve i prezantuar prej 42,000€ ishte nën deklaruar për 3,203€, pasiqë për këtë shumë saldot e llogarive të arkëtueshme nuk ishin të plota. Kjo kishte ndodhur për shkak se Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit, nuk kishte raportuar gjendjen reale të këtyre llogarive.

Lidhur me PFV-të, përveç çështjes së ngritur tek Theksimi i Çështjes dhe atyre tek nënkapitulli 2.2, nuk kemi çështje tjetër që ndërlidhet me cilësinë e PFV.

DEKLARATA NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM (ZKA) DHE ZYRTARI KRYESOR FINANCIAR (ZKF)

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e plotë me disa pasaktësi në shpalosje të tyre.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se do të bëhet në mënyrë adekuate planifikimi i buxhetit për mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve. Po ashtu, kontrollet duhet të jenë më efektive për të siguruar se pasuria jo financiare kapitale dhe llogaritë e arkëtueshme të shpalosen drejtë në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ShSKUK gjatë vitit 2018 ka aplikuar një çasje të përmirësuar në shumë fusha të menaxhimit financiar dhe llogaridhënës, si dhe në zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit të ZKA-së. Komiteti i auditimit në përgjithësi ka luajtur një rol më të shprehur dhe proaktiv në adresimin e gjetjeve të auditimit tek menaxhmenti. ShSKUK kishte adresuar disa nga çështjet specifike të dala nga raporti i auditimit për 2017, siç ishte rasti me pagesat për furnizim me mish për nevoja të kuzhinës së QKUK, duke bërë përmirësime të dukshme të procesit. Tek detyrimet kontingjente kishte pasqyruar të gjitha pretendimet e palëve në pasqyra financiare, nuk kishte vazhduar kontratat kornizë siç ishte rasti i furnizimit me gaz medicinal në vitin 2017, menaxhimin e pasurisë mbi 1,000€ e kishte përmirësuar dukshëm, çështjen e avanceve të pambyllura në bashkëpunim me thesarin e kishte përmirësuar dhe për 2018 nuk kishte avance të hapura. Tek të hyrat kishte caktuar zyrtarin përgjegjës për të bërë harmonizimet, kishte uniformuar pagesat e kujdestarive në tërë sistemin shëndetësor, nuk kishte vazhduar praktikat e rekrutimit përmes listave rezervë apo të pritjes, etj.

Përkundër këtij progresi, ende në disa fusha të menaxhimit kërkohen përmirësime, sidomos në fushën e prokurimit dhe menaxhimit të pasurive, të cilat kërkojnë një përmirësim të kontrolleve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[1]	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**80,915,714**	**85,280,028**	**84,993,518**	**70,553,112**	**69,230,624**
Granti i Qeverisë -Buxheti	80,915,714	84,756,807	84,474,624	70,482,329	66,753,574
Të bartura nga viti paraprak[2]	-	-	-	56,741	223,625
Të hyrat vetjake	-	-	-	-	2,173,125
Donacionet e jashtme	-	523,221	518,894	14,042	80,300

Nga tabela shihet se buxheti fillestar ishte dukshëm më i ultë, por që gjatë vitit kishte pësuar një rritje prej mbi 4.3 milionë. Në vitin 2018, ShSKUK ka shpenzuar mbi 99.66% të buxhetit final ose 84,993,518€, që paraqet një performancë mjaft të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**80,915,714**	**85,280,028**	**84,993,518**	**70,553,112**	**69,230,624**
Pagat dhe Mëditjet	55,938,389	58,243,220	58,242,229	51,586,625	51,294,776
Mallrat dhe Shërbimet	10,863,909	13,789,390	13,659,910	11,380,410	10,812,242
Shërbimet komunale	3,603,416	3,627,963	3,617,547	3,729,638	3,351,393
Investimet Kapitale	10,510,000	9,619,455	9,473,832	3,856,439	3,772,213

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me atë fillestar ishte rritur për 2,304,831€. Kjo ka ndodhur për arsye të mbulimit të shpenzimeve për stafin e ri të angazhuar në ShSKUK i cili ka filluar punën në pjesën e dytë të vitit 2018 duke u bazuar në vendimin e Qeverisë nr. 07/80 të datës 18.12.2018, prej 2,290,307€, pranimi i fondeve nga donatorët në vlerë prej 13,533€, si dhe përshtatjeve të brendshme prej 991€ .
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 2,925,481€, me vendime të Qeverisë për kursime, ndarje, transfere dhe rialokime buxhetore ndërmjet kategorive të shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2018, dhe nga donatorët prej 11,534€.

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[2] Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual

- Buxheti final për investime kapitale është zvogëluar 890,545€, apo në masën prej 8.5%. Këto shkurtime kishin ndodhur si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime, ndarje, transfere dhe rialokime buxhetore ndërmjet kategorive të shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2018.

3.1.1 Të hyrat

ShSKUK kishte bërë planifikim për të hyra në shumën 2,330,000€, ndërsa për periudhën 12 mujore kishte inkasuar shumën prej 2,743,090€, që do të thotë se kishte tejkaluar planin vjetor për 17.8%.

Të hyrat në ShSKUK realizohen nga programe të ndryshme dhe lidhen me shërbimet të cilat ofrohen, siç janë: participimi, të hyrat nga parkingu, qiraja, shitja e shërbimeve, si dhe nga çertifikatat mjekësore. ShSKUK nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të hyrave të realizuara, por të gjitha arkëtimet e të hyrave derdhen në buxhetin e Kosovës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Buxheti final për paga dhe mëditje ishin 58,243,220€, përderisa ishin shpenzuar gjithsej 58,242,229€, pra plani i parashikuar ishte realizuar pothuajse në masën 100%.

Nga testimet e bëra kanë rezultuar çështjen si në vijim:

Çështja B1[3]- Pagesa e kujdestarive në mungesë të dëshmive.

Gjetja

Ligji i Punës nr. 03/L-212, neni 23 Puna më e gjatë se orari jo i plotë i punës, paragrafi 7 përcakton që punëdhënësi është i obliguar të mbaj të dhëna të sakta për punën jashtë orarit.

Në tridhjetë e gjashtë (36) raste kujdestaritë e natës në ShSKUK ishin kompensuar në mungesë të dëshmive për mbajtjen e tyre (ditarëve të kujdestarive). Vlera e paguar në mungesë të dëshmive ishte 11,897€. Poashtu, në 16 raste të testuara kemi identifikuar se të punësuarit nuk ishin evidentuar në sistemin e vijueshmërisë së punës gjatë orarit të rregullt.

Mangësitë e evidentuara kanë ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit efektiv nga ana e drejtorëve të klinikave dhe reparteve.

Rreziku

Mangësitë e evidentuara në kalkulimin e kujdestarive dhe menaxhimin e ditarëve të kujdestarive të natës, rritin rrezikun që të ndodhin pagesa të parregullta dhe potencialisht për shërbimet të cilat nuk janë ofruar.

Rekomandimi B1

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të gjitha njësitë e ShSKUK-së aplikojnë kontrolle monitoruese ndaj procesit të aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive-ndërrimeve të natës në mënyrë që të sigurohet se raportet mujore që procedohen për pagesë janë të bazuara në ditarët e kujdestarive. Ne rekomandojmë kthimin e mjeteve në buxhetin e ShSKUK-së për të gjitha pagesat e paguar për kujdestari të cilat nuk ishin dokumentuar me dëshmi për mbajtjen e tyre. Më tej, të sigurohet se i gjithë stafi do të evidentohet në sistemin e vijushmërisë.

[3] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Çështja B2-Pagesa e shujtës së plotë për punë sekondare

Gjetja Ligji i punës Nr. 03/L-212 neni 11, paragrafi 3, përcakton që ''i punësuari i cili punon me orar jo të plotë pune i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëdhënia e punës në proporcion me orët e punës që ka punuar i punësuari''.

Në ShSKUK, bazuar në listat e pagave për vitin 2018, kemi vërejt se të punësuarve me punë sekondare (me pagë 50% ose 20 orë pune në javë) në ShSKUK, u paguhet shujta e plotë prej 45.76€, njëjtë si edhe stafit i cili është i rregullt me pagë primare dhe punon 40 orë në javë. Nga testimet tona ka rezultuar se kosto e këtyre pagesave ishte 6,200€. Vlenë të theksohet se pas pranimit të raportit tonë të auditimit për vitin 2017, menaxhmenti i ShSKUK-së nga shtatori 2018, kishte ndërmarr masa në përmisimin e kësaj gjendje. Nga 150 pagesa që ishin bërë në muajn korrik për shujtë e plotë ndaj këtyre zyrtarëve, në dhjetor shujta prej 50% iu kishte zbritur afro 120 zyrtarëve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të kërkesave ligjore për dallime në pagesa të shtesave në mes të punës primare dhe sekondare, për stafin i cili punon në dy vende të punës.

Rreziku Mos aplikimi i ndalesave sipas kritereve të përcaktuara me ligj, rrit rrezikun e pagesave kundërligjore dhe shkakton humbje financiare për ShSKUK-në.

Rekomandimi B2 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se me rastin e kalkulimit të shujtave të gjithë zyrtarët përgjegjës të ShSKUK zbatojnë në mënyrë rigoroze të gjitha kërkesat ligjore dhe se pagesa e tilla nuk do të përsëriten.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe komunali ishte 13,789,390€, ndërsa shpenzimi ishte 13,659,910€.

Nga mostrat e testuara substantive dhe mostrat për pajtueshmëri nga kategoria mallra dhe shërbime kemi identifikuar këto çështje që kërkojnë përmirësim.

Çështja A2 – Tejkalim i kontratës për furnizim me gaz medicinal

Gjetja

Paragrafi 1 i nenit 2 të kontratës 6 mujore për "Furnizim emergjent me gazra medicinale" në vlerë 257,828€ e lidhur më 29.09.2017, përcakton "çmimi total i furnizimeve duhet të jetë 257,828€". Po ashtu, paragrafi 2 i nenit 2 të kësaj kontrate përcakton se "çmimi i përmendur në paragrafin 2.1 duhet të jetë e vetmja pagesë të cilën Autoriteti kontraktues i ka borxh ofruesit të shërbimeve. Ai duhet të jetë i plotë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve".

Ne kemi vërejtur se ShSKUK kishte tejkaluar vlerën e kontratës për 74,425€.

Kjo kishte ndodhur për shkakun se komisioni prej katër (4) anëtarëve i caktuar si komision për menaxhimin e kësaj kontrate, kishte bërë mbikëqyrjen e furnizimeve të gazit vetëm për furnizimet e kryera në QKUK, por jo edhe në Spitalet e Përgjithshme.

Rreziku

Mungesa e mbikëqyrjes së plotë dhe të duhur për furnizimet nga komisioni i menaxhimit të kontratës, ka shkaktuar tejkalim të furnizimeve duke sjellë rrezik që të kryhen pagesa të parregullta dhe potencialisht më të larta sesa mund t'i kishte ofruar tregu aktual.

Rekomandimi A2

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se kontratat do të mbikëqyren me kujdes nga menaxheri i kontratës, si dhe të siguroj se asnjë furnizim të mos ndodhë jashtë sasive të kontraktuara.

Çështja A3-Tejkalim i kontratës për furnizim me helium

Gjetja

Për kontratat publike kornizë, neni 38 i LPP parasheh "Autoriteti kontraktues do të specifikoj në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijim prej tij duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%)". Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë -/+ tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Te kontrata kornizë "Furnizimi dhe mbushja me helium e rezonancës magnetike", kemi identifikuar tejkalim të sasive indikative më shumë se 30%. Vlera e kontratës ishte 47,790€, duke shtuar tavanin maksimal prej 30%, totali i pagesave me 30% duhej të ishte 62,127€, ndërsa QKUK kishte paguar për këtë kontratë 73,320€. Edhe pse ishte tejkaluar kontrata kornizë, QKUK nuk e kishte ndërprerë atë.

Shprehur në vlera financiare tejkalimi i sasive indikative ishte 11,193€.

Kjo kishte ndodhur për shkakun se menaxheri i kontratës nuk kishte përcjellë si duhet furnizimet e gjithmbarshme të kontratës.

Rreziku

Mungesa e mbikëqyrjes së duhur ka shkaktuar tejkalim të sasive të caktuara indikative përtej tavanit të lejuar kjo rrit rrezikun pagesave pa kontratë.

Rekomandimi A3

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se kontratat kornizë do të përcillen gjatë implementimit nga menaxherët e tyre, dhe të siguroj se çertifikimi i pagesave nuk do të bëhet mbi tavanin e përcaktuar për kontratat kornizë.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti fillestar për investime kapitale ishte 10,510,000€, gjersa me buxhetin final ishin të ndara 9,619,455€. Ky zvogëlim kishte ndodhur me vendim të Qeverisë. Prej tyre ishin shpenzuar gjithsej 9,473,832€ apo në masën 98.5% e cila paraqet një performancë mjaft të mirë.

Nga 62 mostra të testuara substantive dhe 10 mostra për pajtueshmëri nga kategoria e investimeve kapitale. Pesë mostra të përzgjedhura nga popullacioni i investimeve kapitale në vlerë totale prej 660,160€, nuk janë audituar nga ne për shkak se ishin në procedurë hetimore nga organet kompetente. Këto mostra ne i kemi zëvendësuar me pesë mostra tjera. Për mostrat e përzgjedhura kemi identifikuar këto çështje që kërkojnë përmirësim.

Çështja A4 – Pagesë për servisim të pajisjeve në mungesë të raporteve të servisimit

Gjetja

Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.20 përcakton se "Menaxherët e Projektit duhet të sigurojnë që operatori ekonomik i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës".

Te kontrata publike kornizë "Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore të anestezionit" në vlerë 455,894€ , kemi vërejtur se në dy pagesa në vlerë prej 75,064€ raportet e punës së servisimit nuk e arsyetonin shumën totale të pagesave. Auditimi ynë ka rezultuar me faktin se nga shuma prej 75,064€ raportet e punës për servisim arsyetonin vetëm shumën prej 14,784€, ndërsa vlera 63,883€, nuk ishte e dokumentuar me raporte që tregon se është kryer servisimi.

Po ashtu, edhe në kontratën "Mirëmbajtja dhe servisimi i aparateve mjekësore të anestezionit" e lidhur mes Spitalit të Përgjithshëm të Mitrovicës me po të njëjtin operator, me vlerë prej 113,931€, testimi i një pagesë në vlerë prej 15,381€ për servisim të pajisjeve mjekësore ka rezultuar me faktin se raportet e punës për servisim nga Operatori i angazhuar për servisim nuk e mbulonin shumën totale të pagesës. Raportet e punës për servisim mbulonin vetëm shumën prej 8,401€ gjersa pjesa prej 6,980€, nuk ishte e dokumentuar me raporte që tregon se është kryer servisimi.

Kjo kishte ndodhur për arsye se operatori ekonomik e kishte ndarë kontratën kornizë në proporcion me kohëzgjatjen e saj prej 36 muajve dhe për çdo tre muaj faturonte QKUK-në apo Spitalit të Përgjithshëm të Mitrovicës në mënyrë lineare duke mos i mbështetur në raporte të gjitha faturimet. QKUK dhe Spitali Regjional i Mitrovicës kishte paguar këto fatura për shkak të kontrolleve të dobëta qoftë në menaxhimin e kontratës, ashtu edhe në çertifikimin e lëndëve.

Rreziku

Nënshkrimi i raporteve për pranimin e shërbimeve nga menaxheri kontratës, për shërbimet e pa kryera nga ana e kontraktorit ka shkaktuar dëmtimin e buxhetit të ministrisë prej 70,863€, si dhe mos përfitimin e vlerës për para.

Rekomandimi A4 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të merr masa të menjëhershme për shqyrtimin e këtij rasti dhe të siguroj se të gjitha pagesat për servisim të pajisjeve mjekësore për të cilat nuk janë pranuar shërbimet, të kërkoj nga operatori që t'i kthej mjetet në buxhetin e ShSKUK. Gjithashtu, duhet të forcohen masat e përgjegjësisë që menaxherët e kontratave të mos nënshkruajnë asnjë raport pranimi, para se shërbimet të jenë kryer.

Çështja A5- Pagesa e paradhënies në kundërshtim me ligjin e buxhetit

Gjetja Sipas Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, neni 13 paragrafi 4 parasheh "në muajin nëntor pagesa e paradhënies është e kufizuar deri në dhjetë për qind (10%) të vlerës së kontratës".

Për projektin "Ndërtimi i Deposë afër Repartit të Dializës në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt" në vlerë 59,420€, ishte bërë pagesë nga kodi ekonomik 31122 Objekte shëndetësore në formë e paradhënies në vlerë 11,884€, apo 20% e vlerës së kontratës në muajin nëntor 2018.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Spitali i Përgjithshëm i Ferizajt është përpjekur të bëjë më shumë pagesa në kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2018 për të mos mbetur suficit mjetet e dedikuara si dhe me qëllim të rritjes ekzekutimit të buxhetit në këtë kategori.

Rreziku Pagesa e paradhënies jo në pajtim me ligjin e buxhetit, rrit rrezikun që të ndodhin pagesa të parregullta dhe për pagesën e dhënë mos të merret kundërvlera e kontratës.

Rekomandimi A5 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se të gjitha pagesat në paradhënie, duhet të bëhen në harmoni me ligjin e buxhetit.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive dhe sigurojnë të dhëna të sakta dhe të azhurnuara për pasuritë e organizatës. Vlera e pasurive mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte 231,639,077€, ndërsa nën 1,000€ ishte 4,818,824€.

Ne kemi testuar saldon fillestare, blerjet e vitit duke përfshirë investimet kapitale dhe blerjet për pajisje dhe mobilje nën 1,000€ nga mallrat dhe shërbimet, si dhe rregullsinë në evidentimin dhe inventarizimin e pasurisë në dispozicion.

Ne kemi testuar gjithsej 100 mostra nga kategoria e pasurive, dhe dobësitë e identifikuara janë përshkruar si më poshtë.

Çështja A6 –Evidentim i pasurive nën 1,000€ të paregjistruara në e-pasuria

Gjetja

Neni 6 i rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, parasheh që pasuria jo kapitale duhet të regjistrohen në modulin e-pasuria.

Në ShSKUK pasuritë nën 1,000€ të blera gjatë vitit 2018 nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria ashtu siç parashihet me rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Të dhënat për pasuritë nën 1,000€ ishin mbajtur në regjistra individual të secilës njësi vartëse të ShSKUK.

Vlen të theksohet se vetëm Spitali i Përgjithshëm i Ferizajt ka filluar të aplikoj regjistrimin në sistemin e-pasuria të pasurive nën 1,000€, por ky regjistër nuk ishte i saktë. Në PVF 2018 pasuria nën 1,000€, në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt ishte prezantuar me vlerën 56,729€, ndërsa në regjistrin e-pasuria pasuria nën 1,000 ishte 97,549€.

Pasuria e blerë nën 1,000€, nuk ishte regjistruar në modulin e-pasuria për shkak se zyrtarët e pasurisë nuk kishin çasje në këtë modul, edhe pse kishin kërkuar nga Ministria e Financave t'iu lejonte çasjen. Ndërsa, prezantimi jo i drejt i pasurisë nën 1,000€ në PVF 2018, kishte ndodhur për shkak të bashkëpunimit të dobët në mes të zyrtarit të pasurisë dhe departamentit të financave.

Rreziku

Mos regjistrimi i pasurive nën 1,000€, në sistemin e e-pasurisë rrit rrezikun që pasuritë nën 1,000€të mos administrohen dhe raportohen si duhet.

Rekomandimi A6

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që e tërë pasuria e blerë apo e përvetësuar e ShSKUK-së duhet të regjistrohet në modulin e-pasuria.

3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Në librin kryesor gjendja e parasë së imët dhe avanceve të hapura në ShSKUK për 2018 është 177€. Për dallim nga viti i kaluar, Thesari kishte bërë shkarkimin e llogarisë së avanceve të hapura nga llogaria e ShSKUK-së pasiqë ato nuk i takonin këtij entiteti, por një entiteti tjetër (Ministrisë së Shëndetësisë).

Rekomandim

Nuk kemi ndonjë rekomandim në këtë fushë.

3.4 Të arkëtueshmet

Shërbimi Spitalor Klinik i Universitetit të Kosovës kishte shpalosur në PFV–të e vitit 2018, llogari të arkëtueshme në vlerë totale prej 42,000€.

Nën deklarimin e kësaj kategorie e kemi raportuar tek kapitulli i opinionit të auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi ndonjë rekomandim në këtë fushë.

3.5 Obligimet e papaguara

Obligimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishin 2,428,070€, përderisa në PFV e vitit 2017 ishin deklaruar 2,680,973€. Krahasuar me vitin paraprak, kemi një zbritje të obligimeve të papaguara prej 9.4% në vitin 2018.

Struktura e obligimeve të vitit 2018, sipas kategorive është, mallra dhe shërbime 1,578,868€ apo 65% e totalit, komunali 108,609€ apo 4.5% e totalit, dhe shpenzime kapitale 740,591€ apo 30.5%.

Pjesëmarrja më e lartë në obligime të papaguara e ka QKUK me 1,240,392€ apo 51.1%, më pas Spitali i Prizrenit me 549,160€ apo 22.6%, Spitali i Gjilanit me 390,288€ apo 16.1%, si dhe Spitalet tjera regjionale dhe programet tjera me gjithsej 248,229€ apo 10.2%.

Çështja A7- Normë e lartë e obligimeve të papaguara në disa njësi të SHSKUK

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare 01/2013, neni 12 paragrafi 3 përcakton se organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara.

ShSKUK nuk kishte menaxhuar si duhet obligimet e papaguara, sidomos tek kategoria mallra dhe shërbime dhe investime kapitale sepse kishte hyrë në obligime financiare më shumë se sa ndarjet buxhetore. Ndarjet buxhetore për mallra dhe shërbime ishin 13,789,390€, shpenzimet 13,659,910€, përderisa obligimet në këtë kategori ishin 1,578,868€.

Edhe te kategoria investime kapitale ShSKUK ka hyrë në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore. Buxheti për investime kapitale ishte 9,619,455€, shpenzimi 9,473,832€, përderisa obligimet në fund vit në PFV ishin raportuar 740,591€.

Shkaku i normës së lartë të obligimeve është si vijon; në QKUK si rezultati i buxhetit të pamjaftueshëm në mallra dhe shërbime dhe komunali kanë mbetur të papaguara obligimet në vitin 2018, në kategorinë e investimeve kapitale ka pasur vonesa në lifererim të mallit/pajisjeve apo punëve dhe nuk ka mundur të realizohet plani sipas parashikimeve. Në S.P. të Prizrenit kryesisht mungesa e buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime dhe komunali ka shkaktuar obligime të papaguara. S.P. të Gjilanit menaxhimi i obligimeve të papaguara nuk është në nivel adekuat pasiqë edhe nga vitet paraprake janë bartur mjaft obligime sidomos në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Rreziku

Shumat e raportuara të obligimeve të pa paguara janë shuma domethënëse për buxhetin e ShSKUK-në, dhe si të tilla, mund të ndikojnë në prishjen e balancave buxhetore që ulin shkallën e likuiditetit.

Rekomandimi A7

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të angazhohet në përmirësimin e menaxhimit të obligimeve, duke parandaluar hyrjen në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore dhe t'i jap prioritet shlyerjes së borxheve ekzistuese.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike. Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen

Ministrisë së Financave. Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar gjatë vitit 2018 ka trajtuar me kujdes të shtuar projektet e rëndësisë nacionale – ofrimi i shërbimit 24 orësh në klinikën e kardiokirurgjisë, e cila dukshëm ka reduktuar rastet e trajtimit jashtë vendi për sëmundjet kardiake, kujdes të shtuar kishte treguar në funksionalizimin e trajtimeve ambulantore, menaxhimin e përmirësuar të sistemit të vijueshmërisë së punonjësve, menaxhimin më adekuat të parkingut respektivisht hyrje daljeve. Në 2018 kishte filluar të aplikoj edhe modernizimin e aparaturave nëpër klinikat e saj duke shtyrë para digjitalizimin e shërbimeve.

Organizata ka bërë shumë përmirësime në sistemin e përgjithshëm të qeverisjes. ShSKUK ka treguar një përkushtim të shtuar në zbatimin e rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit të ZKA-së. Komiteti i auditimit në përgjithësi ka luajtur një rol më të shprehur në adresimin e gjetjeve të auditimit tek menaxhmenti. Po ashtu, tek çështjet specifike të dala nga raporti i auditimit për 2017, kishte bërë përmirësime të proceseve, siç ishte rasti me pagesat për furnizim me mish për nevoja të kuzhinës së QKUK, tek detyrimet kontingjente kishte pasqyruar të gjitha pretendimet e palëve, kishte ndërprerë kontratat kornizë siç ishte rasti i furnizimit me gaz medicinal në vitin 2017, menaxhimin e pasurisë mbi 1,000€ e kishte përmirësuar dukshëm, çështjen e avanceve të pambyllura në bashkëpunim me thesarin e kishte përmirësuar, dhe për 2018 nuk kishte avanse të hapura, tek të hyrat kishte caktuar zyrtarin përgjegjës për të bërë harmonizimet, kishte uniformuar pagesat e kujdestarive në tërë sistemin shëndetësor, kishte ndërprerë praktikat e rekrutimit përmes listave rezerve apo të pritjes.

Përkundër progresit të dukshëm, ShSKUK ende ka dobësi në disa fusha të qeverisjes. Kontrollet financiare nuk ishin efektive në parandalimin e pagesave për shërbimet e pakryera të servisimit, pastaj shuma e konsiderueshme e obligimeve të pa paguara në fund të vitit, tejkalimi i sasive te kontratat e furnizimeve me gaz dhe helium, mos caktimi i menaxherëve të kontratave në raste të caktuara, raportet e mangëta aty ky kishte menaxher kontratash, etj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në ShSKUK operon me Drejtorin e NJAB dhe dy (2) anëtarë të stafit, prej të cilëve njëri është rekrutuar gjatë vitit 2018. Linja e raportimit të NJAB përfshin Bordin e ShSKUK-së dhe Drejtorin e Përgjithshëm si dhe Komitetin e Auditimit.

NjAB kishte hartuar planin strategjik për periudhën 2017-2019 ku kishte identifikuar rreziqet e veprimtarisë. Po ashtu, bazuar në planin strategjik NjAB kishte përpiluar edhe planin vjetor për vitin 2018, i cili ishte miratuar nga Bordi drejtues dhe Komiteti i Auditimit.

Gjatë vitit 2018 ishte themeluar Komiteti i ri i Auditimit i cila ka qenë funksional, ka statutin e aprovuar dhe gjatë vitit kishte mbajtur 4 takime. Komiteti në përgjithësi e përkrah NjAB-në, dhe komunikon aktivisht me Bordin Drejtues me kërkesa dhe rekomandime për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së.

NjAB për vitin 2018 kishte planifikuar dhe realizuar gjithsej shtatë (7) raporte. Bazuar në rekomandimin e vitit të kaluar për rritjen e kapaciteteve të stafit, NJAB kishte rekrutuar edhe një staf shtesë. Megjithatë, edhe gjatë vitit 2018, sfidë mbetet zbatimi i rekomandimeve të NjAB nga ShSKUK.

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për një planifikim të mirë, për mbikëqyrje të aktiviteteve në baza të rregullta dhe për vendimmarrje efektive, menaxhmenti i ShSKUK ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëj me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet e masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë ministrinë.

ShSKUK ka shumë njësi vartëse: Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës, Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë , Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Qendra Kombëtare e Telemjekësisë, Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë, Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, Spitali i Përgjithshëm në Pejë, Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë, Spitali i Përgjithshëm në Prizren, Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri, Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime. Në nivele të raportimit menaxherial këto njësi raportojnë tek Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi Drejtues i ShSKUK-së, ndërsa për aktivitetet operative raportojnë tek Zyrtarët Kryesor Administrativ të njësive.

Në aspektin e raportimit financiar raportet e këtyre njësive konsolidohen në nivelin më të lartë hierarkik, pra në ShSKUK. Cilësia e raportimit të tyre në ShSKUK është përmirësuar ndjeshëm, mirëpo ende ka nevojë për përmirësime sidomos në fushën prokurimit, ndarjes së detyrave, administrimit të pagesave të kujdestarive si dhe menaxhimi me pasuritë nën 1,000€.

Menaxhmenti i ShSKUK-së përgjatë vitit ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet. Ne kemi konfirmuar se masat e aplikuara janë në përmirësim e sipër dhe gradualisht janë duke u orientuar kah përgjigjja efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Krahasuar me vitet paraprake, ShSKUK ka treguar një rol shumë aktiv në parandalimin e dobësive të përcjella vit pas vit si në nivelin e raportimit menaxherial, ashtu edhe në fushën operacionale.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të ShSKUK-së kishte rezultuar me 19 rekomandime. ShSKUK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Vlen të theksohet se ShSKUK kishte trajtuar me seriozitet raportin e auditimit të vitit 2017, më ç'rast kishte themeluar një komision për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve. Ky komision kishte përcjellë me vëmendje zbatimin e rekomandimeve dhe kishte raportuar te menaxhmenti për progresin e arritur.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, prej 19 rekomandimeve, 9 rekomandime janë zbatuar apo 47%, dy (2) ishte në proces të zbatimit apo 11% e tyre, shtatë (7) kanë mbetur të pazbatuara apo 37% dhe një (1) rekomandim i pazbatuar i mbyllura apo 5%.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se është bërë një analizë të çështjeve që kanë ndikuar në theksim të çështjes. Të siguroj se me rastin e përgatitjes së PFV, do të prezantohen drejtë të gjitha detyrimet kontingjente.	Në PFV e 2018, janë prezantuar detyrimet kontingjente	Rekomandim i zbatuar
2		Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojnë se është bërë regjistrimi i të gjitha pasurive mbi 1,000€ në regjistra e pasurive si dhe për pasurit nën 1,000€ të bëjë zhvlerësimin në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe saktë.	Në PFV e 2018, janë prezantuar pasuritë e plota mbi 1,000€. Me qenëse regjistri i pasurive nën 1,000€ është jo i plotë edhe zhvlerësimi është jo i plotë.	Rekomandim i pjesërisht i zbatuar
3		Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm së bashku me thesarin duhet të rishikoj problematikën me avancet e pambyllura dhe të siguroj mbylljen e tyre.	Avancet e paarsyetuara janë shkarkuar nga llogaria e ShSKUK dhe janë të sakta në prezantim.	Rekomandim i zbatuar
4		Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se shpenzimet do buxhetohet dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël.	Shpenzimet ende nuk janë buxhetuar konformë rregullave financiare të duhura.	Rekomandim i pa zbatuar
5		Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojnë se kontratat publike kornizë nuk do të vazhdohen në kundërshtim me ligjin.	Nuk ke pasur vazhdim të kontratave publike kornizë.	Rekomandim i zbatuar
6	Të hyrat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë respektimin e kërkesave ligjore në lidhje me menaxhimin e të hyrave duke ndërmarrë të gjitha masat e	Është caktuar zyrtari i të hyrave në nivel të ShSKUK-së.	Rekomandim i zbatuar

		nevojshme në mënyrë që organizata të ketë zyrtarin e të hyrave në nivel të ShSKUK-së.		
7	Të hyrat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se respektojnë kërkesat ligjore në lidhje me menaxhimin e të hyrave duke siguruar se hyrat mbi 10€ të realizohen përmes llogarisë bankare.	Nuk janë marrë masa	Rekomandim i pa zbatuar.
8	Pagat dhe shtesat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se është duke u aplikuar Kontrata Kolektive Sektoriale. Poashtu të siguroj se asnjë shtesë nuk paguhet pa u mbështetur në bazë të qartë ligjore	Janë unifikuar pagesat e kujdestarive.	Rekomandim i zbatuar
9	Pagat dhe shtesat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se është bërë ndalesa prej 50% në shujta për të gjithë punonjësit e angazhuar me pagë sekondare.	Ka filluar të implementohet por ende nuk është finalizuar	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
10	Pagat dhe shtesat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të gjitha njësitë e ShSKUK-së aplikojnë kontrolle monitoruese ndaj procesit të aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive-ndërrimeve të natës në mënyrë që të sigurohet se raportet mujore që procedohen për pagesë janë të bazuara në ditarët e kujdestarive.	Nuk janë marrë masa adekuate në 2018	Rekomandim i pazbatuar
11	Pagat dhe shtesat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që në një kohë sa më të arsyeshme/afërt të zhvilloj procedurat konform kërkesave ligjore për plotësimin e pozitave udhëheqëse të cilat mbahen me ushtrues detyre. Poashtu, duhet të sigurojë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me orar të plotë të punës.	Janë marrë masa efektive, mirëpo ende ka shumë ushtrues detyre sidomos tek shefat e klinikave.	Rekomandim i pazbatuar
12	Pagat dhe shtesat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë	Është ndërprerë kjo praktike.	Rekomandim i zbatuar

		që procesi i rekrutimit të stafit të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore dhe të shpallet konkursi i ri për çdo pozite të lirë të punës, sipas kërkesave ligjore		
13	Mallrat dhe shërbimet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që furnizimi i mishit bëhen në përputhje me kushtet e cekura në kontratë.	Janë marrë masa efektive dhe të gjitha furnizimet janë të mbuluara me certifikata origjine.	Rekomandim i zbatuar
14	Mallrat dhe shërbimet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që procedimi i urdhër blerjeve të bëhet në përputhje me kërkesat dhe procedurat e përcaktuara ligjore.	Janë marrë masa efektive dhe nuk kemi hasur në asnjë rast ku urdhër blerjet shtypen pas furnizimeve.	Rekomandim i zbatuar
15	Investimet kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se nuk bëhen pagesa para se të merret shërbimi.	Edhe në vitin 2018 kemi pasur raste kur pagesa është bërë para se shërbimi të merret .	Rekomandim i pazbatuar
16	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se menaxhimi i pasurisë jo kapitale të organizatës të bëhet konform udhëzimeve dhe të merren masa në drejtim të trajnimit të stafit dhe funksionalizimit të sistemit e-pasuria. Regjistrat e pasurisë duhet të jenë të plota, të përmbajnë të gjitha elementet siç përcaktohet me udhëzimet përkatëse si dhe të azhurnohen në vazhdimësi.	Ende nuk janë marrë masa adekuate.	Rekomandim i pazbatuar
17	Obligimet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të angazhohet në përmirësimin e menaxhimit të obligimeve dhe duhet t'i jap prioritet shlyerjes obligimeve në mënyrë që pagesa e faturave të bëhet kohë.	Ende nuk janë marrë masa adekuate.	Rekomandim i pazbatuar
18	Progresi në zbatimin e rekomandi meve	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që është zbatuar plani adekuat i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të	ShSKUK ka vendosur kontrolle të shtuara për të adresuar rekomandimet në vazhdimësi. Ka krijuar një ekip i cili është duke përcjellë vazhdimisht progresin e zbatimit të	Rekomandim i pazbatuar i mbyllur

		rëndësishme.	rekomandimeve.	
19	Sistemi i auditimit të brendshëm	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të NjAB-së, duhet të bëj përpjekje për shtim të kapaciteteve në kuadër të NjAB-së. Gjithashtu të sigurojnë se NjAB është e fokusuar në auditimin e fushave kyçe dhe me rrezik të lartë në mënyrë që menaxhmentit t'i ofrojë siguri të mjaftueshme për funksionimin e kontrolleve të brendshme. Më tutje, të siguroj se ndërmerren masat e duhur (monitorim e zbatimit) për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.	ShSKUK ka marrë masa adekuate në drejtim të shtimit të stafit. NjAB ka qenë e fokusuar në auditimin e fushave kyçe përgjatë 2018.	Rekomandim i zbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
A1	PFV	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se do të bëhet në mënyrë adekuate planifikimi i buxhetit për mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve. Po ashtu, kontrollet duhet të jenë më efektive për të siguruar se pasuria jo financiare kapitale dhe llogaritë e arkëtueshme të shpalosen drejtë në PFV.		
B1	Pagat dhe shtesat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të gjitha njësitë e ShSKUK-së aplikojnë kontrolle monitoruese ndaj procesit të aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive-ndërrimeve të natës në mënyrë që të sigurohet se raportet mujore që procedohen për pagesë janë të bazuara në ditarët e kujdestarive. Ne rekomandojmë kthimin e mjeteve në buxhetin e ShSKUK-së për të gjitha pagesat e paguar për kujdestari të cilat nuk ishin dokumentuar me dëshmi për mbajtjen e tyre. Më tej, të sigurohet se i gjithë stafi do të evidentohet në sistemin e vijushmërisë.		
B2	Pagat dhe shtesat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se me rastin e kalkulimit të shujtave të gjithë zyrtarët përgjegjës të ShSKUK zbatojnë në mënyrë rigoroze të gjitha kërkesat ligjore dhe se pagesa e tilla nuk do të përsëriten.		
A2	Mallrat dhe shërbimet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se kontratat do të mbikëqyren me kujdes nga menaxheri i kontratës, si dhe të siguroj se asnjë furnizim të mos ndodhë jashtë sasive të kontraktuara.		
A3	Mallrat dhe shërbimet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se kontratat kornizë do të përcillen gjatë implementimit nga menaxherët e tyre, dhe të siguroj se çertifikimi i pagesave nuk do të bëhet mbi tavanin e përcaktuar për kontratat kornizë.		
A4	Investimet kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të merr masa të menjëhershme për shqyrtimin e këtij rasti dhe të siguroj se të gjitha pagesat për servisim të pajisjeve mjekësore për të cilat nuk janë pranuar shërbimet, të kërkoj nga		

		operatori që t'i kthej mjetet në buxhetin e ShSKUK. Gjithashtu, duhet të forcohen masat e përgjegjësisë që menaxherët e kontratave të mos nënshkruajnë asnjë raport pranimi, para se shërbimet të jenë kryer.
A5	Investimet kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se të gjitha pagesat në paradhënie, duhet të bëhen në harmoni me ligjin e buxhetit.
A6	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që e tërë pasuria e blerë apo e përvetësuar e ShSKUK-së duhet të regjistrohet në modulin e-pasuria.
A7	Obligimet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të angazhohet në përmirësimin e menaxhimit të obligimeve, duke parandaluar hyrjen në obligime më shumë se sa ndarjet buxhetore dhe t'i jap prioritet shlyerjes së borxheve ekzistuese.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK

LETËR E KONFIRMIMIT
Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve,i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Basri Sejdiu _____
Drejtor i Përgjithshëm - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës

Data: 27.05.2019, Prishtinë,

1